

## FUNKSIONET E PËRRALLËS SIPAS VI. J. PROPIT

*Myzafere Mustafa*

Prishtinë

KUD

Punim studimor

Marrë për botim 10.1.1994

**P ë r m b a j t j a e s h k u r t ë r:** Në punim shqyrtohet vepra e VI. J. Propit «Morfologjia e përrallës». Propi kishte qëllim t'i zbulojë ligjshmëritë e përrallës si zhanër më vete. Këtë e kishte arritur nëpërmjet të përkthimit të hollësishëm sinkronik të përrallës. Njësi konstante, sipas tij, janë funksionet (gjithsej 31). Renditja e tyre është e pandryshueshme, me mundësi të zhvendosjes apo të përsëritjes së disa syresh. Nga renditja logjike e funksioneve, sipas rrjedhës së veprimit, formohet struktura kompozicionale unike, nga e cila dalin katër kategori të përrallës.

Përveç trajtimit të funksioneve, si invariante të përrallës, Propi studion edhe sistemin e roleve apo të fushëveprimeve të personazheve.

Në bazë të modelit të strukturës kompozicionale të Propit, është bërë analiza e dy përrallave shqipe, njëra me një rrjedhë të ndodhisë dhe me funksionet T - A dhe tjetra me katër rrjedha dhe me funksionet L - V.

Nga analiza shihet se përralla shqipe mund të inkuadrohet në modelin e Propit, kuptohet duke pasur parasysh zhvendosjen e disa funksioneve. Veçoritë specifike të përrallës shqipe shprehen në situatën initiale, ku shpjegohet qëllimi i largimit apo i shkuarjes së heroit kryesor nga shtëpia, pastaj në veçoritë dhe tiparet e personazheve, në figurat e ndryshme mitologjike dhe në tiparet e tyre që lidhen me religjionin e lashtë të traditës që i takojnë, në mënyrën e kryerjes së veprimeve, në mjetet e shumta mitike etj.

Përralla ka zgjuar interesimin e shumë studiuesve të krijimtarisë letrare gojore, njëri ndër ta, V. J. Prop, u bë i njohur më studimin «Morfologjia e përrallës», të cilin e botoi me 1928 në gjuhën ruse në Leningrad. Ky studim ra në harresë deri në vitet e pesëdhjeta, kur u përkthye në gjuhën angleze,<sup>1</sup> ndërsa në vitet e gjashtëdhjeta e më vonë u përkthye

1 Shih: V. P r o p p, *Morfology of the Folktale*, Edited with an Introduction by Svatava Pirkova - Jacobson, translated by Laurence Scott, Indiana University Research Center in

edhe në shumë gjuhë botërore.<sup>2</sup> Interesimi për të u shtua në kohën kur kishte marrë hov metoda strukturale e studimeve gjuhësore.

Qëllimi i Propit nuk ishte t'i përshkruajë veprimet poetike, por t'i zbulojë specifikat, ligjshmëritë krijuese të përrallës si zhanër (lloj) më vete i krijimtarisë letrare gojore. Këtë e arriti nëpërmjet të përshkrimit sinkronik të përrallës, ku më pastaj zbuloi elementet e përhershme (konstante) të saj, të cilat i quajti funksione. Termi funksion nënkupton veprimin e personazhit të caktuar, të determinuar nga aspekti i rëndësisë që ka në rrjedhën e veprimit. Funksionet, sipas tij, janë invariante të përrallës, e në bazë të tyre përcaktohet struktura kompozicionale.

Vlen të theksojmë se edhe para Propit shumë studiues ishin marrë me studimin e përrallës, ata kryesisht si element mbështetës i merrnin motivet

Antropology, Folklore and Linguistics, Publication ten. Bloomington, 1958.

U ribotua edhe në: International Journal of American Linguistics ( vol. 24. no 4. pt 3); Bibliographical and Special Series of the American Folklore Society (vol. 9). Morphology of the Folktale, Second edition, revised and edited with a Preface by Luis Wagner. new Introduction by Alan Dundes, University of Texas Press, Austin- London, 1968.,

2 Shih: Vl.Ja. Propp, Morfologia della fiaba, con un intervento di Claud Lévi - Strauss e una replica dell'autore, a di Gian Luigi Bravo. Nuova Biblioteca Scientifica Inaudi, 13, Torino, 1966; Vl. Ja. Propp, Morphologie du conte, Traduit du russe par Claud Ligny. Editions Gallimard (Bibliotheque de Sciences humains, Paris, 1970; Më 1969 u përkthye në sllovakisht dhe u botua në Bratisllavë; më 1972 u përkthye në gjermanisht, u botua në Mynchen; u përkthye në japonisht u botua në Tokio 1972. Në serbokratisht: Vl. Jakovljević Prop, Morgologija bajke, preveo Petar Vujišić në: treći program Radio Beograda, leto 1975, f. 273 - 390. U ribotua më 1982 me titull: V. Prop, Morfologija bajke, preveli Petar Vujišić, Radovan Matijašević, Mira Vuković, Prosveta, Beograd 1982. Në këtë libër janë botuar edhe punimet: Vladimir Prop, Transformacije u bajkama, të cilin autori e kishte botuar më 1928 në Leningrad; Klod Levi Stros, Struktura i forma, razmišljanja o jednom delu Vladimira Propa. Ky punim ishte në botimin italisht të Morfologjisë së Propit më 1966.; Vl. Prop, Strukturalno i istorijsko pručavanje bajki, ky punim ishte botuar si përgjigje Levi Strosit në botimin italisht të morfologjisë; E.M. Meletinski, Strukturalno -tipološko proučavanje bajke, ky punim ishte botuar në Moskë më 1968, po ashtu ishte botuar si parathënie e disa botimeve të Morfologjisë në disa gjuhë. Autori shkruan në mënyrë shumë afirmative për këtë studim, bën analizën e hollësishme të Morfologjisë e krahas kësaj trajton edhe shumë çështje lidhur me studimin strukturalist; ai gjithashtu i shqyrton edhe shumë punime të studiuesve të njohur botërorë, të cilët, të nxitur nga vepra e Propit, kishin bërë studime të tëra për ta shpënë më tutje çështjen e studimit të miteve dhe të zhanreve të letërsisë gojore (jo vetëm të përrallës) dhe të zhanreve të tjera të letërsisë së shkruar. Ndër ta vlen t'i përmendim Lévi - Strossin, A. I. Greimans-in, Claude Bremond-in, E. K. Kängäs, P. Maranda, Alan Dundes e të tjerë.

Vepra e Propit edhe sot e gjithë ditën mbetet fundamentale për shumë çështje të studimit të përrallës e krahas saj edhe të prozës gojore. Studiuesi i njohur i përrallës Max Lüthi, i cili konsiderohet si njëri ndër studiuesit më të thellë të rrafshit stilistik të përrallës thotë: "Mund të thuhet se Morfologjia e Propit është vepër me rëndësi largpamëse... analiza e Propit e strukturës dhe analiza ime e stilit përplotësohen ndërsjelltas". (Max Lüthi, Das europäische Volksmärchen: Form und Wesen München, 1976, f. 121).

dhe syzhetë e përrallës, megjithëse disa bashkëkohanikë të Propit kishin hapur shteg dhe kishin krijuar një bazë të mirë për studimin e përrallës nëpërmjet zbulimit të njësive konstante dhe të ndryshueshme të përrallës.<sup>3</sup>

Para Propit disa studiues konsideronin se motivet janë elemente konstante të përrallës, e këta ishin: A.N.Veselovski<sup>4</sup>, K. Spiess<sup>5</sup>, F. von der Leyen, etj., ndërsa Antti Aarne, përpilues i katalogut ndërkombëtar të syzheve të llojeve të prozës gojore, konsideronte se bazë e krijimit gojor të prozës është syzheu. Studimi i përrallës në bazë të motiveve dhe të syzheut nuk mund të jepte fryte, meqë nëpërmjet të motiveve dhe syzheut nuk mund të përcaktohen veçoritë specifike të përrallës dhe ligjshmëritë e formësimit të saj. Arsytet janë të shumta, por njëra ndër to është se motivi nuk është njësi (monadë) e pandashme e përrallës dhe ai mund të zbërthehet edhe në njësi më të vogla, prandaj edhe mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme, si dhe një motiv mund të haset në disa syzhe të përrallave dhe në zhanret e tjera të prozës gojore. Ky ishte shkaku që Propi nuk u bazua në motive dhe syzhe, por kërkoi rrugë të tjera për studimin e përrallës.

Nga studimi i tij del se përralla ka 31 funksione, e secili funksion ka pastaj edhe disa nënndarje. Renditja e tyre është suksesive dhe e pandryshueshme, por lejohen mundësitë e zhvendosjes apo të përsëritjes së disa funksioneve në rrjedha të ndryshme të veprimit. Ndryshimi apo zhvendosja e funksioneve nuk e ndryshon mendimin sipas të cilit përrallat janë unike nga tipologjia, ndërsa të ngjashme morfologjikisht.

Secili funksion është definuar sipas veçorive themelore, i cili është përmbledhur në një term si bie fjala: «largimi», «ndalesa», «shkelja», «mungesa», «shkaktimi i dëmit» etj., e pastaj është dhënë shenja nga kodi me shkronjë apo me simbol.

Çështjen e mundësisë së zhvendosjes së funksioneve Propi e shpjegon

3 J. B e d i e r, qysh më 1893 kishte konstatuar se në përrallë ekziston një raport në mes të njësive të perhershme dhe njësive të ndryshueshme (shih: J. Bedier, *Les fabliaux*, Paris 1893 cit. sipas *Morfologjia...* f. 21); A. I Nikoforov më 1926 kishte shkruar një punim dhe e kishte botuar me 1928 në të cilin vërente ligjshmëritë e përsëritjes së elementeve dinamike në përrallë, ligjshmëritë e boshtit kompozicional dhe ligjshmërinë kategorike apo gramatikore të formësimit të ndodhisë. Sipas mendimit të tij veprimi në përrallë mund të ndahet në: "veprime prefiksale" (ku ekziston mundësia e ndryshimeve të shumta), "veprimet rrënjësore" të cilat pothuajse nuk mund të ndryshojnë dhe veprimet "sufiksale" dhe "fleksive". Për shumë koncepte Nikoforov ishte shumë afër Propit.

4 A. N. V e s e l o v s k i motivin e konsideronte element primar, ndërsa syzheun sekondar. Motivi sipas tij është njësi e pazbërthyeshme e rrëfimit. Shenjë e motivit është skematizmi i tij pitoresk dhe një elementësh. (Sipas V. Prop në *Morfologji...* f.20).

5 Shih edhe K. S p i e s s, *Das deutsche Volksmarchen*, Ausg. 3, Leipzig 1925.

me "lirinë e caktuar" të rrëfimitarit - krijuesit. Funkzionet e renditura në mënyrë lineare përmbledhen në një rrëfim suksesiv dhe përbëjnë strukturën unike kompozicionale të përrallës. Funkzionet janë elemente themelore nëpërmjet të cilave ndërtohet rrjedha e veprimit. Renditja e funksioneve krijon kompozicionin që e përbëjnë të gjitha predikatet, ndërsa subjektet, objektet dhe pjesët e tjera të fjalive e përcaktojnë syzheun. Subjektet, objektet dhe fjalitë janë të ndryshueshme dhe si pasojë e kësaj kompozicioni i njëjtë gjendet në bazën e syzheve të ndryshëm. Duke u bazuar në strukturën kompozicionale, Propi jep këtë definicion: përralla është tregim i ndërtuar sipas renditjes së rregullt të funksioneve në mënyra të ndryshme me mundësi të heqjes apo përsëritjes së disa syresh.

Propi pra, veçoritë qenësore të përrallës nuk i sheh në të çuditshmen por në kompozicion, në veçoritë strukturale, në sintaksë, të cilave u përgjigjet uniteti i poetikës, i botës së ideve, i emocioneve, i heronjve dhe i mjeteve gjuhësore. Më tutje ai eksplikon këtë duke shtuar: Morfologjikisht përrallë mund të quhet çdo zhvillim që nga shkaktimi i dëmit apo mungesa, ku pasojnë funksionet e tjera deri te dasma, apo funksionet e tjera që shërbejnë si shturrje.

Nga kjo del se përralla ka një strukturë kompozicionale virtuale, që shërben si strumbullar i të gjithë syzheve të përrallave, e cila realizohet gjatë rrëfimit.

Shtatë funksionet e para, sipas Propit, përbëjnë pjesën përgatitore të përrallës ( e - largimi, k - ndalesa, q - shkelja, v - marrja e informatave, w - dhënia e informatave, j - mashtrimi, g - pjesëmarrja). Katër funksionet vijuese ( X - shkaktimi i dëmit ose x - mungesa, Y - ndërmjetësimi, W, - fillimi i kundërshtimit, ↑ - shkuarja ) përbëjnë thurrjen. Me funksionin E - eleminimi i problemit apo i mungesës, arrihet kulminacioni i rrëfimit, ndërsa funksionet e tjera zhvillojnë rrjedhën e përrallës.

Sipas këtij studimi shihet se disa funksione mund të përmbledhen në çifte funksionesh (funksione binare) si: ndalesa - shkelja, lufta - fitorja, mungesa - eliminimi, ndërsa disa funksione të tjera mund të përmbledhen në grupe apo sekuenca, si bie fjala ( Y - ndërmjetësimi, njoftimi, W - fillimi i kundërshtimit, ↑ - shkuarja (YW↑), të cilat po ashtu janë njësi konstante dhe përbëjnë sistemin e pandryshuar të strukturës kompozicionale unike të përrallës. Zbulimi i dukurisë së funksioneve binare ka rëndësi të madhe në studimin struktural jo vetëm për përrallën po edhe për mitet dhe llojet e tjera. Një përrallë vështirë mund t'i ketë të gjitha (31) funksionet e theksuara më lart. Kjo strukturë mund të shprehet në trajtën e një formule:



6. Fushëveprimi *i heroit* përfshin: shkuarjen në kërkim - W↑, reagimin në kërkesat e dhurtëdhënësit - H, dasmën N.

7. Fushëveprimi *i personazhit të rremë* përfshin: shkuarjen në kërkim - W↑, reagimin në kërkesat e dhuratëdhënësit, gjithherë negativ - H neg dhe kërkesat e pabazë - F.

Nga kjo ndarje shihet se fushëveprimi i përgjigjet saktësisht personazhit. Një fushëveprim përfshin disa personazhe dhe një personazh mund t'i ketë disa fushëveprime.

Propi, pra përrallën e analizon edhe në nivelin e sistemit të personazheve. Përveç këtyre shtatë roleve apo fushëveprimeve, ekzistojnë edhe personazhet që i vëjnë lidhjet e këta janë: ankuesit, dëftuesit, mashtruesit si dhe tradhëtarët e veçantë për funksionin w - dhënia e informatave.

Mënyra e inkuadrimit të personazheve në veprim po ashtu bëhet sipas rregullave të caktuara. Kundërshtari, bie fjala, shfaqet dy herë. Herën e parë shfaqet papritmas, shkakton dëmin dhe zhduket. Herën e dytë hyn si personazh i gjetur. Dhuratëdhënësi haset rastësisht në pyll, në ndonjë shtëpi, në fushë, në rrugë etj. Ndhmësi mitik futet si dhuratë. Ai moment shënohet me shkronjën Z. Dërguesi, heroi, heroi i rremë, dhe e bija e mbretit inkuadrohen që në situatën fillestare. Për heroin e rremë, në situatën fillestare nganjëherë nuk thuhet asgjë, por më vonë shihet se ai jeton në pallat. E bija e mbretit shfaqet dy herë, herën e dytë inkuadrohet si personazh i gjetur, me ç'rast kërkuesi së pari mund ta hasë atë e pastaj kundërshtarin, apo edhe në të kundërtën.

Kjo mënyrë e inkuadrimit të personazheve, sipas Propit, është normë e përrallës. Mirëpo edhe inkuadrimi i personazheve ndonjëherë mund të ndryshojë, me ç'rast thuhet kjo normë.

Në strukturën e përrallës elemente të rëndësishme janë edhe *atributet e personazheve*. Me atributet e personazheve Propi nënkupton tërësinë e veçorive të jashtme të personazheve: moshën, gjininë, pozitën, pamjen etj. Të gjitha këto përrallës ia japin një gjallëri dhe kolorit të veçantë. Në to hetohet një dozë e përsëritjeve, por në bazë të tyre krijohen kanonet e përrallës, si bie fjala, trajtat ndërkombëtare, trajtat nacionale, trajtat provinciale, trajtat e kategorive sociale etj.

Studimi i funksioneve, i attributeve dhe i elementeve të tjera ndihmëse, në bazë të të cilave do të mund të bëhej përpilimi i tabelës së elementeve të përgjithshme të përrallës, e cila i ka 150 njësi, sipas Propit do të mundësonte të ndërtohet praforma e përrallës, jo vetëm skematikisht por edhe praktikisht. Duke i eliminuar elementet sekondare do të mbeteshin vetëm trajtat themelore, në ç'mënyrë do të konstruktohej përralla sipas të cilës të gjitha përrallat e tjera të jenë variante të saj. Përrallë

themelore, sipas tij, është ajo në të cilën kuçedra e rrëmben vajzën e mbretit, ku Ivani e takon baba Jagën, e fiton kalin, fluturon, me ndihmën e kalit e mund kuçedrën, kthehet, e ndjekin kuçedrat, i takon vëllëzërit ... etj., pra përralla me funksionet L-V.

Elementet ndihmëse luajnë rol në lidhjen e funksioneve dhe të episodeve të përrallës. Vënia e lidhjeve shënohet me simbolin  $\cup$ , pastaj janë elementet që shërbejnë për përcaktimin e përsëritjes së veprimeve si, bie fjala, vënia e parë në sprovë, vënia e dytë dhe vënia e tretë, apo heqja e një koke të kuçedrës, heqja e kokës së dytë dhe heqja e kokës së tretë, ose personazhi e humb mjetin e parë mitik, e kërkon të dytin, e humb edhe atë e gjen të tretin. Elementet e vazhdimësisë të tillë shënohen me simbolin:- *vazhdimësia*.

Elemente ndihmëse konsiderohen edhe *motivacionet*, sipas të cilave personazhet detyrohen të kryejnë veprimet e ndryshme. Motivacionet i japin përrallës ngjyrim të theksuar. Edhe pse janë elemente variabile, ato kanë ndikim në mënyrën e renditjes së funksioneve e si pasojë e kësaj lindin e variantet.

Mënyrat e ndryshme të kryerjes së veprimeve si dhe elementet variabile, sipas Propit, duhet konsideruar si kompozicion artistik, ndërsa nga krahasimi i formulave me elemente atributive fitohet një zingjir lidhës në mes të rrafshit logjik dhe artistik.

Nga analiza e tërësishme e përrallës, që e bëri Propi, shihet se ai pati vështirësi të ndryshme në përcaktimin e elementeve apo njërive konstante. Njëra ndër to ishte se shpeshherë vështirë bëhet diferencimi i funksioneve, meqë gjatë zhvillimit dhe transformimit historik të përrallës janë bërë *asimilime* të ndryshme të funksioneve. Kështu që, herë-herë, vështirë dallohen funksioni i verifikimit të personazhit nga dhuratëdhënësi apo furnizuesi, nga funksioni i detyrës së rëndë dhe kryerja e saj. Këtu, si solucion për përcaktimin e funksionit Propi e ka pasojën apo rezultatit që vie pas këtij funksioni. Nëse pas ballafaqimit me personazhin tjetër, heroi i përrallës fiton mjetin mitik me të cilin edhe më tutje vazhdon rrugën për objektin apo personin e kërkuar, atëherë është fjala për verifikimin apo vënien në sprovë të heroit nga dhuratëdhënësi - D dhe reagimin e tij - H, si dhe marrjen e mjetit mitik Z. Ndërsa, nëse personazhi kryesor ballafaqohet me një personazh tjetër dhe e mund atë e si pasojë është fitimi i mjetit të kërkuar e pas saj edhe martesë, atëherë është fjala për funksionet T - A (detyrat e rënda - kryerja). Kjo kërkesë për dallimin e këtyre funksioneve, sipas E.Meletinskit, ka rëndësi të madhe meqë opozicioni i këtyre dy funksioneve (*të verifikimit preliminar*, me ç'rast heroit i jepet mjeti mitik dhe *verifikimit kryesor*, që shpie në likuidimin e

mungesës) është i lidhur në mënyrën më substanciale me specificitetin e përrallës si zhanër.

Propi trajton edhe çështjen e transformimit të përrallës. Ky transformim bëhet nëpërmjet të reduktimeve, të ndryshimit të disa elementeve që lidhen me dukuri sociale dhe gjeografike, nëpërmjet të amplifikimit (zgjerimit) të elementve të ndryshme etj.

Analizën e përrallës Propi e kishte bërë në 100 përralla ruse, të cilat ai i konsideronte përralla të mirëfillta mitike, e që në klasifikimin e Aarne-Thompsonit janë sistemuar nën numrat 300 - 749. Ai analizon përrallat me një dy, tri e më shumë rrjedha dhe me rrjedha të kombinuara. Në mesin e këtyre përrallave janë ato ku veprimi kryhet në bazën e funksioneve L - V (lufta - fitorja), T - A (detyrat e rënda - kryerja), pastaj përrallat me këto dy palë funksione dhe përrallat pa asnjërin nga këto dy palë funksione.

Për të parë se si duket analiza e përrallës konkrete, sipas modelit të Propit, më poshtë do të japim dy përralla shqipe, njëra ka një rrjedhë të veprimit dhe funksionet *detyrat e rënda* dhe *kryerja* e tyre ( T - A ) dhe tjetra ka katër rrjedha të veprimit funksionet *lufta-fitorja* ( L - V ).

#### DJALI I VARFËR DHE E BUKURA E DHEUT <sup>6</sup>

Kjo përrallë ka një rrjedhë të ndodhisë. Veprimi zhvillohet nëpërmjet të detyrave të rënda - T dhe kryerjes së tyre - A.

Një plakë kishte pasur një djalë. (Situata fillestare - i). Vendos djali të punojë (Mungesa e parave -  $x^5$ ). Shkon te një plak (Shkuarja -  $\uparrow$ ). Punon një motmot dhe vendos të largohet. Ia kërkon paratë agait, ai i ofron treqind groshë haram ose tre groshë hallall. (Vënia në provë nga dhuratëdhënësi -  $D^1$ ). Djali vendos të marrë tre groshë hallall. (Reagimi i heroit, i përgjigjet sprovës .  $H^1$ ). Merr djali paratë (fitimi i mjetit mitik -  $Z^1$ ). Vazhdon rrugën, shkuarja -  $\uparrow$ ). Afër detit takon një peshk të ngordhur. (Funksioni i parë i dhuratëdhënësit -  $d^7$ ). Ia vë një para në vesh, peshku ngjallet (shërbimi i kryer, veprimi fisnik .  $H^7$ ). Peshku ia dhuron tri hala, i preferon t'i ngrohë në zjarr kur të gjendet në sitata të vështira. (Të fituarit e mjetit mitik, mjeti jepet -  $Z^1$ ). Më tutje takon një hutë të madhe të ngordhur -  $d^7$ . Ia vë edhe asaj groshin në vesh -  $H^7$ . Ngjallet huta dhe ia dhuron tri pupla, - $Z^1$ ). Takohet me një skile, përsëritet veprimi i njëjtë  $d^7H^7 Z^1$ . Vazhdon djali rrugën. (Bartja hapësinore - $R^2$ ). Arrin te një plakë. (Arritja inkognito -  $^0$ ). Atje e Bukura e Dheut kishte qitur fjalën se do të martohet me njeriun që arrin të fshehet nga ajo. (Detyrat

<sup>6</sup> *Antologji e përrallës shqipe*, përgatitur nga Anton Berisha - Myzafere Mustafa, Rilindja, Prishtinë, 1982 f.189-195.

e rënda - T). Fshehet djali herën e parë, E Bukura e Dheut e gjen - A neg. Fshehet herën e dytë, prapë e gjen ( T - A neg). Fshehet herën e tretë, nuk e gjen. (T - A) Kryhet detyra. (Në tri rastet fshehet me ndihmën e ndihmësit mitik). Martohen. martesë-N).

Skema funksioneve të kësaj përralle do të dukej kështu:

$$\begin{array}{rcl}
 & d^7 H^7 Z^1 & T - \text{Aneg} \\
 i x^5 I D^1 H^1 Z^1 I & d^7 H^7 Z^1 R^0 & T - \text{Aneg } N \\
 & d^7 H^7 Z^1 & T - A
 \end{array}$$

Analizë e përrallës me katër rrjedha të veprimit

### NANDË MAJE GJUHËT<sup>7</sup>

Vëlla e motër (Situata fillestare - i ) Vëllau del në gjueti (largimi - e). I thotë motrës: «ndër të gjitha odat mundesh me kërkue, veç n' ma t' epren odë ruej se hin» (Ndalesa - k<sup>1</sup>). «Njitet motra në katin e syperm, u ep çilc odavet e gjen divin e lidhun me hekra» (Shkelja e ndalesës - q<sup>1</sup>). Merren vesh me divin ta mashtrojnë vëllaun e saj dhe ta mbysin, që pastaj të martohen (Motivacioni). Motra tani është personazh kundërshtar siku-rse edhe divi. Shtiret ajo si e sëmure (Bindjet mashtruese të kundërshtarit - j<sup>1</sup>). Vëllau u beson mashtrimeve të saj. (heroi i nënshtrohet propozimit të kundërshtarit - g<sup>1</sup>). Për t'u shëruar, ajo kërkon nga vëllau t'ia sjellë qumështin e nanës së Mushës. (Mungesa-x<sup>6</sup> dhe dërgimi Y<sup>2</sup>). Vëllau pranon të shkojë (Pranimi dhe shkuarja. W ↑).

Kur arrin atje, ballafaqohet me Mushën (Ballafaqimi me dhuratë-dhënësin e disponuar armiqësisht - D<sup>9</sup>). E mund Mushën, (Tejkalimi i vënies në sprovë -H<sup>9</sup>). Musha ia jep tamlin e kërkuar (E -eliminimi i mungesës), por ia jep edhe një mollë (mjetin mitik), të cilën i preferon ta përdorë kur të mbetet më së ngushti. (Marrja e mjetit mitik - Z<sup>9</sup>). Kthehet. (Kthimi ↓). Motgra prapë e kërkon qumështin e nanës së Bokshit. Përsë-ritet i njëjti veprim D<sup>9</sup> H<sup>9</sup> Z<sup>9</sup>=E. Motra përsëri kërkon nga vëllau tamlin e nënës së Tokshit. Ai prapë pranon të shkojë dhe kemi D<sup>9</sup> H<sup>9</sup> Z<sup>9</sup>=E

Rrjedha e dytë

Motra dhe divi e lidhin heroin dhe duan ta mbysin. (Përpjekja për

7. P. Donat Kurti, O.F.M., *Prralla Kombtare*, mbledhë prej gojës së popullit, ble I, botim i dytë, Shkodër, Shtyp. "A. Gj. Fishta", 1942, f. 144-149.

mbytje  $X^{14}$ ). Heroi kërkon ta lejojnë t'i përdorë mjetet mitike. Mjetet mitike njoftojnë për rrezikun e djalit (Njoftimi për fatkeqësinë -  $Y^4$ ). Vijnë tre probatimat - Musha, Bokshi, Tokshi (Kthimi - ↓) E shpëtojnë djalin nga vdekja (Eliminimi i fatkeqësisë -  $E^9$ ). E dënojnë motrën dhe divin. (Dënimi - Pu).

#### Rrjedha e tretë

Niset djali (heroi) për kurbet. (Shkuarja - ↑). Rrugës e takon të bijën e mbretit duke qarë së, donte ta hajë kuçedra. (Kërcënimi për ngrënie -  $x^{17}$ ). Djali i premton se do ta shpëtojë nëse ajo e merr për burrë. (Motivimi). Vie kuçedra, djali ndeshet me të. (Lufta -  $L^1$ ). E mbyt kuçedrën. (Fitorja,  $-V^1$ ). (Bashkohen si të martuar -  $n^2$ ).

#### Rrjedha e katërt

Rrugës njeriu i egër e mbyt djalin. (Mbytja -  $X^{14}$ ). Heroi i rremë e detyron vajzën e mbretit të thotë se ai e ka mbytur kuçedrën, që të martohet me të. (Kërkesat e pabazë të heroit të rremë - F). Heroin e vdekur e ruan kali. Në ndërkohë kalbet molla (mjeti mitik) dhe aroma e mollës shkon deri te Musha, ai informohet për fatkeqësinë. (Njoftimi për fatkeqësinë -  $Y^4$ ). Vie Musha (tani në funksionin e ndihmësit mitik), ia fshin fytyrën me peshqir dhe Tokshi informohet për fatkeqësinë. (Njoftimi -  $Y^4$ ). Tokshi me fyell e informon Bokshin. (Njoftimi -  $Y^4$ ). Të tretë e ngjallin heroin. (Eliminimi i fatkeqësisë - ringjallja -  $E^9$ ). Djali i hyp gjokut. (Bartja hapsinore -  $R^2$ ). Arrin të mbreti (Arritja inkognito -  $^0$ ). E mbyt njeriun e egër. (Dënimi - Pu). I tregon nëntë majet e gjuhës. (Njohja e heroit - I). Martohet me vajzën e mbretit. (Martesa dhe marrja e frontit -  $N^*$ ).

Skema e funksioneve të kësaj përralle do të dukej kështu:

$$I \quad i e k^1 j^1 g^1 x^6 y^2 W \uparrow (D^9 H^9 Z^9) \cdot 3 = E$$

$$II \quad x^{14} Z Y^4 \downarrow E^9 Pu$$

$$III \quad x^{17} L - V n^2$$

$$IV \quad x^{14} F Y^4 E^9 R^{2^0} Pu I N^*$$

Siç theksuam edhe më lart, përralla *Djali i varfër dhe e Bukura e Dheut* ka një rrjedhë të veprimit. Struktura kompozicionale e saj i përgjigjet skemës së strukturës së përrallës sipas Propit. Funkcioni x - mungesa, këtu nuk shpjegohet në mënyrë eksplicite, prandaj edhe shkaku i largimit dhe

i shkuarjes së heroit mund të shpjegohet edhe si dëshirë e personazhit kryesor të dalë të shohë, që në një mënyrë nënkupton kërkimin e fatit për martesë. Në përrallë shohim se ai paratë që i kishte fituar (paratë hallall) janë në funksion të mjetit mitik, meqë me to ai e kalon sprovën nga tre dhuratëdhënësit, të cilët ia dhurojnë tri mjetet mitike, më të cilat i kryen detyrat e rënda, e kalon sprovën kryesore, pas të cilave pason martesë. Kryerjen e detyrave të rënda T, heroi e bën nëpërmjet të mjeteve mitike, prandaj edhe para funksioneve T kemi mundur t'i japim edhe këto shenja:  $Y^4 \downarrow$  që do të thotë se djali e thërret në ndihmë dhuratëdhënësin  $Y^4$  që tani është në funksion të ndihmësit, vie ai ( $\downarrow$ ) dhe e fsheh por nuk arrin ta kryejë detyrën = Aneg. Kjo do të përsëritej tri herë. Nuk i kemi shënuar këto, duke pasur parasysh se kryerjen e detyrave të rënda pothuaj se të shumtën e rasteve e kryejnë mjetet apo ndihmësit mitikë, pra një gjë e tillë është krejtësisht e natyrshme për përrallën.

Në përrallën e dytë *Nandë maje gjuhët*, e cila i ka katër rrjedha të veprimit në fillim kemi një episod, të cilin nuk e kemi shënuar në skemën e analizuar. Pas situatës, fillestare-i, rrëfimtari shpjegon se njëherë heroi është larguar nga shtëpia dhe është ndeshur me divin, e ka zënë rob dhe e ka mbyllur në një odë. Ky episod i shpjeguar nga rrëfimtari jepet për ta arsyetuar ekzistimin e divit të mbyllur, prandaj edhe nuk e kemi shënuar. Edhe shkuarjen dhe ardhjen e heroit në rastin e kërkimit të mjetit mitik herën e dytë dhe të tretë nuk i kemi dhënë në skemë, meqë vënia në provë e heroit tri herë nga dhuratëdhënësit është pothuaj e kodifikuar në përrallë, prandaj e kemi shënuar vetëm një herë  $Y^4 W \uparrow$ , ndërsa D H Z është dhënë tri herë.

Zgjedhjen e përrallave për analizë nuk e kemi bërë pas ndonjë seleksionimi, prandaj në këtë rast nuk mund të bëjmë fjalë në aspekt përgjithësues lidhur me skemën e strukturës së përrallës shqipe sipas modelit të Propit.

Vlen të theksojmë se përralla shqipe ka një strukturë komplekse dhe shumë të pasur. Në të hasen shumë qenie e figura mitologjike, që heqin gjurmë nga religjionet shumë të lashta. Hasim po ashtu edhe përralla të pasura për nga realizimi i ndodhisë dhe i rrjedhave të veprimit. Çështja e largimit të heroit të përrallës në raste të ndryshme është mjaft komplekse. Të gjitha këto meritojnë qasje të veçantë.

*Myzafere Mustafa*

## LES FONCTIONS DU CONTE MERVEILLEUX SELON V.J. PROP

Dans son oeuvre "La morphologie du conte" Prop s'est donné pour but de découvrir les règles du conte merveilleux en tant que genre à part. Selon lui les unités constantes du conte merveilleux sont les fonctions, qui d'après un ordre logique sa structure compositionnelle unique est formée de quatre catégories.

A part l'étude des fonctions en tant qu'invariantes de le conte merveilleux Prop étudie aussi le système des rôles des personnages.

Suivant le modèle de la structure compositionnelle de Prop, nous avons analysé deux conte merveilleux en albanais, dont une avec un seul cours d'événements et avec les fonctions T-A, l'autre avec quatre cours d'événements et avec les fonctions T-A.

D'après cette analyse on peut voir que du conte merveilleux albanaise peut s'encadrer au modèle de Prop. Les particularités spécifiques du conte merveilleux albanaise s'expriment au début ou l'on donne le motif de l'éloignement du héros de chez lui, ensuite s'expriment les particularités et les traits des personnages, les différentes figures mythologiques, leurs traits qui sont liés à la religion ancienne et les manières dont on assume les activités.